REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2694/8 **Prot.** **Patos, më** 22/09/ **2026**

PROCESVERBALI I TAKIMIT 21 SHTATOR 2026

Temë: "Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027"

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak Patos

Ora: 13:30

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", VKB nr. 83, datë 17.12.2025 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027", si dhe njoftimit me nr. 2694/4 prot., datë 20.08.2026 me lëndë dëgjesë publike "Rishikim i ndryshimeve të projekt dokumentit të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit për vitin 2027".

Pjesëmarrës: ZV/ Kryetar i bashkisë Patos, znj. Ina Sauli, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme znj. Juela Shpata, Drejtor i Financave, znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, z. Çajup Refitaj.

24 Pjesëmarrës prej të cilëve:

- Anëtarë këshilli;
- Kryetarë të fshatrave:
- Përfaqësues nga bashkia Patos;
- Përfaqësues nga institucionet arsimore dhe të rinjtë;
- Përfaqësues nga grupe të ndryshme interesi.

Takimin hapet nga Sekretar i Këshillit Bashkiak, znj. Refaela Xeba- Të nderuar të



Sekretar i Këshillit Bashkiak
znj. Refaela Xeba

Dëgjesë publike me temë:
Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-
2029 dhe buxhetit 2027

pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Qëllimi i kësaj dëgjese është rishikimi i kërkesave buxhetore për PBA 2027-2029 dhe buxhetit 2027. Ju ftoj të dëgjojmë prezantimin nga ana e ekzekutivit dhe më pas mund të drejtoni pyetjet dhe rekomandimet tuaja.

Drejtore e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari– Përshëndetje të gjithëve! Sot jemi për rishikimi dhe është dhe finalizimin i buxhetit përfundimtar dhe PBA-së. Nuk kanë ndryshuar burimet janë po ato që kemi rishikuar dhe nqse ju keni kërkesa shtesë sepse të gjitha ato që



Drejtore e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së

2027-2029 dhe buxhetit 2027

janë thithur dhe ne kemi marrë në dëgjesa janë pasqyruar dhe buxhetuar. Dhe buxheti u miratua në qershor dhe në fazën e rishikimit do rimarrim kërkesa të reja dhe të themi se çfarë janë marrë parasysh dhe materializuar në këtë buxhet. Kërkesat tuaja janë përfshir në buxhet për pjesën e mirëmbajtjes së shkollave, për ambjentet. Fati i mirë është qëndy shkolla në po i përfundojmë "Sotic Çapo" dhe jemi në proces prokurimi për shkollën "Hekuran Maneku". Që të dyja këto projekte i kanë të gjitha të përfshira me palestra me aktivitet sportiv. Të gjitha ambjentet janë më standarde kohore, bashkëkohore që përshtaten për mësimdhënie për nxënësit dhe mësuesit. Për pjesën e mirëmbajtjes së shkollave, kërkesat që keni patur ju janë të buxhetuara dhe të përfshira për vitin 2027 dhe për pjesët e programeve të tjera, sepse ju i i ntereson programi i arsimit dhe kulturës,dhe kërkesat e tjera që kanë ardhur nga grupet e interesit janë përfshirë në buxhetim për pjesën e projekteve që ne mbulojmë me buxhetet ton. Për ato projekte që kanë vlera që ne nuk i përballojmë dot më buxhetin tonë janë projekte të bërë gati të cilat do tu përgjigjen thirrjeve sa herë janë gati nga ministrit përkatëse apo projekt përkatës. Për këtë jemi mbledhur sot nqse keni kërkesa shtesë për buxhetin e rishikuar ose atë përfundimtar. Faleminderit!

Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

Mësues në shkollën "Sotir Kola", z. Mustafa Demiraj- Kemi një kërkesë po jashtë buxhetit dhe më shumë pak lekë kjo mund të rregullohet. Ne kemi vite që nuk kemi një sallë personeli. Brenda shkollës të bëhet një ndarje klase. Klasa është shumë e madhe. Unë e kam diskutuar dhe herë të tjera kur më është dhënë mundësia.



Mësues në shkollën "Sotir Kola"
z. Mustafa Demiraj
Dëgjesë publike me temë:
Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

Drejtore e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari– Do t'ja përcjellim në ndërmarrje këtë



Drejtore e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari
Dëgjesë publike me temë:
Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

kërkesë dhe të shikojmë mundësinë dhe mund ta zgjidhim dhe për këtë vit deri ne dhjetor.

Mësuese koordinatore, znj. Vjollca Kasaj- Duke qenë se unë jam mësuese koordinatore në



Mësuese koordinatore
znj. Vjollca Kasaj
Dëgjesë publike me temë:
Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

atë shkollë jam në dijeni dhe mësuesit rrin në korridor nuk knë një zyrë. Nuk kanë mjedis për të ndenjur dhe mësuesit që rrijnë në pushim nuk kishin një karrige për të ndenjur. Të paktën dy tavolina dhe disa karrige dhe të krijohet mundësia e një personeli për të punuar sepse me hapjen e klasave tani nuk ka mjedis. E duta unë do thoja që ajo shkollë ka nevojë edhe për disa stola të tjerë ku të ulen nxënësit. 3 stola keni cuar atje janë 60 nxënës. Nëse ka mundësi

brenda një kohë të shkurtër 1 javë ose 2 të vendosen një tavolinë dhe disa karrige të kenë mundësi të ulen mësuesit.

Sekretar i përgjithshëm, znj. Juela Shpata- Për pjesën e bazës materiale unë e kam thënë të bëjnë kërkesë sepse në bazë materiale kemi të mirëmbajtur shumë të mirë. I kemi zvendësuar para një jave shkollës në Belinë të gjitha dërrasat e zeza. Na thoni sa doni sepse bazë materiale kemi pafund.



Sekretar i përgjithshëm
znj. Juela Shpata
Dëgjesë publike me temë:
Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

Drejtore e kopshtit nr. 2, z. Flutura Hoxha- Për pjesën e bazën materiale dhe mjete didaktike, kancelari, formate, lapsa që të kenë mundësi nesë një prind nuk ka mundësi të blej



Drejtore e kopshtit nr. 2
z. Flutura Hoxha
Dëgjesë publike me temë:
Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

paketën e librave, cfarë mund të bëjmë ndonjë gjë? Që dhe ne të kemi mundësi të argëtojmë fëmijët. Sepse kopshti është falas dhe lodrat dhe mos të thonë që nuk i argëtojmë. Dhe pjesa e kopshtit nr. 2 ka ngelur pjesa e rikonstruksionit sepse sikur u kalua në buxhet. Dhe gjatë mbledhjes së parë kishim edhe dicka lidhur me kopshtin në Oficinë, pjesën e ndarjes së oborrit të shkollës me kopshtin. Të bëhet dicka që mos të përzihen me shkollën fëmijët. Të jetë një ambjent i përshtatëshëm, të ketë disa lodra, ndonjë stol.

Drejtore e Financave, z. Mimoza Shtëmbari- E ka të shkruar të zezë në të bardhë që mjetet



Drejtore e Financave, z. Mimoza Shtëmbari
Dëgjesë publike me temë:
Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

didaktike i mbulon ministria e Arsimit. Ju nëse nuk keni marrë duhet ti kërkoni. Me Vkm ne mbulojmë vetëm pjesën e mirëmbajtjes, por për pjesën kancelarikë për fëmijët do shikojmë cfarë mund të bëjmë por jo për libra. Ta rishikojmë si kërkesë. Sa i përket rikonstruksionit është duke ndjekur të gjitha proceset që do marri rrugën e prokurimit sepse duhet oponencë nga Ministria dhe nga institucionet e tjera.

Drejtoresh e kopshtit Zharrëz, znj. Miranda Mete- Nëse mund të shtoj diçka për bazën materiale didaktike nuk dua të përsëritem, por unë do thosha të shikohej dhe njëher mirëmbajtja e kopshtit jo nga godina, por ne nuk kemi asnjë tapet në të gjitha kopshtet e njësis Zharrëz për të shtruar. Fëmijët janë në cimento, nuk kanë marrë ndonjëherë tapet ka shumë vite dhe nuk kemi marrë. Kërkesa i kemi bërë. Na duhen dhe rafte për të vendosur. Problem në Frahsër ne kemi sepse duam një depozit për ujë sepse nuk ka ujë. Me ditë të nuk ka ujë. Furnizimi m detergjentë duhet të përshpejtohet sepse po i blejmë vet.



Drejtoresh e kopshtit Zharrëz, znj. Miranda Mete
Dëgjesë publike me temë:
Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

Sekretare e pergjithshmë, znj. Juela Shpata- Kopshti nr. 1 cdo gjë do e ketë të re, por dhe



Sekretare e pergjithshmë znj. Juela Shpata
Dëgjesë publike me temë:
Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

te kopshti që ne kemi transferuar aktualisht kemi pafund bazë materiale të mirëmbajtur, ka tapeta, rafte, tavolina, por nuk mund ti marrim që tani sepse i kanë në përdorim të gjitha. Të gjitha do transferohen më vonë.

Drejtoresh e kopshtit nr. 1, znj. Burbuqe Nexha- ne na duhen regjistrër për kopshtin sepse nuk kemi dhe po i blejmë vet për fëmijët për databazën. Nuk kemi regjistra sepse shkollat i hedhin ne smip dhe ne nuk kemi smip dhe që atëherë Ministria e Arsimit i ka hequr.



Drejtoresh e kopshtit nr. 1
znj. Burbuqe Nexha

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

Drejtore e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari- DARI, zyra arsimore e çdo bashkie i alokohet fond për kancelari dhe ju duhet të bëni kërkesën. Megjithatë sillni formatin e regjistrit për ta parë dhe për ta porositur në shtypshkronjë dhe bëni kërkesën që tua sjellim.



Drejtore e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari

Dëgjesë publike me temë:

Rishikim i ndryshimeve të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

Adresa: Lagjia "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos